

L I G J
Nr.8195, datë 3.3.1997

PËR DISA MASA NË KUADRIN E GJENDJES SË JASHTËZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Aleksandër Meksit, Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe deputet,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Të gjithë rebelët e armatosur të dorëzojnë armët, municionet dhe lëndët eksplozive brenda orës 14⁰⁰ të datës 3.3.1997. Pas kësaj ore rebelët e armatosur qëllohen pa paralajmërim.

Neni 2

Ushtarakët aktivë dhe rezervistë që nuk zbatojnë detyrat e ngarkuara dënohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal Ushtarak për gjendjen e jashtëzakonshme.

Neni 3

Prokuroria të fillojë menjëherë hetimet për organizatorët dhe frymëzuesit e revoltës.

Neni 4

Vendosen kufizime për ushtrimin e lirisë së shtypit dhe informacionit. Ndalohet botimi, shpërndarja, transmetimi në organet e shtypit e të radios të materialeve që nxisin ose bëjnë thirrje për veprime të dhunshme kundër sigurimit kombëtar, rendit kushtetues, sigurisë publike dhe jetës së individit. Organet e përditshtme të shtypit dhe të medias janë të detyruara të botojnë në përmbajtje të plotë njoftimet zyrtare që lidhen drejtpërdrejt me situatën e gjendjes së jashtëzakonshme.

Organet e shtypit detyrohen të miratojnë përpara shtypjes, lëndën e çdo numri, te shtabi lokal i zbatimit të gjendjes së jashtëzakonshme, i cili bllokoi çdo organ që nuk respekton këtë dispozitë.

Neni 5

Shërbimi ushtarak i shtetasve të radhës, që kryejnë shërbimin ushtarak zgjatet deri në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme.

Neni 6

Njësitë e prodhimit dhe shitjes së bukës detyrohen të mos ndërpresin veprimtarinë dhe i nënshtrohen urdhrave të shtabit lokal të mbrojtjes.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi më datën 3.3.1997, ora 1⁰⁰.

Shpallur me dekretin nr.1728, datë 3.3.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha